

10 këshilla

për të komunikuar
me efikasitet të
drejtat e njeriut

[E RE]

Të ngresh zërin për të drejtat e
njeriut nuk ka qenë asnjëherë më
e rëndësishme se sa sot!

Por si mund ta bëjmë më së miri?


Si t'i bashkojmë njerëzit dhe të
bëjmë diferencën?

Këshilla 1

Përcakto objektivat e tu



Tregohu i qartë se çfarë dëshiron të arrish



Përse duhet të përcaktosh objektivat?

- Synimet e qarta janë baza e strategjisë tënde.
- Synimet përcaktojnë audiencat, kanalet dhe formatet – nuk ndodh e kundërta!
- Synimet e arritura janë dëshmi suksesi.

Si?


- Mbjaj synime realiste – mendo për burimet dhe afatet që ke.
- Përcakto treguesit kyç të performancës dhe vlerat e synuara për të matur suksesin.
- Ndaji synimet me të tjerët për të arritur një vizion të përbashkët.

Këshilla 2

Përfshi audiencat e tua



Dëgjo dhe kupto të tjerët



**Përse duhet
t'i përfshish
audiencat?**

- Për të kuptuar se çfarë i motivon njerëzit.
- Për të gjetur pika të përbashkëta.
- Për të përforcuar besimin reciprok.

Si?


- Vendos audiencat të synuara qartë për mesazhet e tua.
- Dëgjo audiencat dhe përdor grupet e fokusit dhe aftësitë analitike.
- Pyet dhe fto audiencat që të bëjnë pyetjet e tyre.

Këshilla 3

Jepi zë vlerave të përbashkëta



Gjej pika të përbashkëta



**Përse duhet
t'i japim zë
vlerave të
përbashkëta?**


- Vlerat janë parimet që na udhëheqin.
- Problemet ndajnë, por vlerat bashkojnë.
- Vlerat e përbashkëta mund të përfshijnë dhe forcojnë komunitetet me kalimin e kohës.

Si?


- Analizo vlerat e tua dhe ato të audiencës.
- Gjej vlerat e përbashkëta që përforcojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë.
- Fokusohu tek emocionet dhe vlerat më të mira të njerëzve.

Këshilla 4

Krijò koalicione



Krijoi partneritete për t'u zgjeruar më shumë



**Përse duhen
krijuar
koalicione?**


- Për të shumëfishuar mesazhet e tua.
- Për të arritur audiencë më të gjera.
- Për të nxitur mirëkuptim më të gjerë dhe më të thellë, si dhe ndjenjat e empatisë.

Si?


- Gjej synime dhe përfitime reciproke me partnerë të rinj.
- Bëj lidhjen midis të drejtave dhe temave me interes.
- Ushqe marrëdhëniet afatgjata – bashkërendo dhe ndaj rezultatet.

Këshilla 5

Organizo “lajmëtarët”



Fto zëra të besuar për të të ndihmuar ta përhapësh lajmin



Përse duhet të organizosh "lajmëtarët"?

- Për të tërhequr vëmendjen e audiencave të reja.
- Për të nxitur njerëzit të tregojnë historitë e tyre.
- Për ta bërë mesazhin sa më autentik.

Si?


- Nxiti që të përdorin stilin e tyre.
- Lidhi me audiencën dhe synimin tënd kryesor.
- Investo në mirëqenien e tyre.

Këshilla 6

Ngjall shpresë



Frymëzo veprimin me anë të mesazheve pozitive



**Përse duhet
ngjallur
shpresa?**

- Të drejtat e njeriut janë shpresa jonë për një të ardhme më të mirë.
- Entuziazmi dhe pasioni na nxisin të vazhdojmë përpara.
- Jeta mund të jetë e vështirë. Bëhu një rreze shprese!

Si?


- Ji pro dhe jo kundër – përqendrohu te zgjidhjet, jo te problemet.
- Jepi rëndësi synimeve të tua.
- Lidh hapat e vegjël me panoramën e përgjithshme.

Këshilla 7

Jepi jetë historisë tënde



Përdor shembuj nga jeta e përditshme për të ngjallur emocione



Përse duhet
t'i japësh jetë
historisë
tënde?


- Historitë i japin jetës një kauzë më madhore.
- Ato na ndihmojnë të kuptojmë, të shfaqim empati dhe të përfshihemi me të tjerët.
- Ngjallja e emocioneve mund të ketë efekt që zgjat.

Si?

- Merr parasysh se kë do të motivojë historia jote.
- Përkruaj një sfidë, cilët janë heronjtë dhe zgjidhjet e saj.
- Trego se si vështirësia e një personi mund të ndihmojë të tjerët.

Këshilla 8

Zgjidh platformën tënde



Përshtate qasjen tënde me kanalin e zgjedhur



Përse duhet të zgjedhësh një platformë?

- Si përmbajtja, ashtu edhe stili kanë rëndësi.
- Ka shumë mënyra për t'u vënë re nga të tjerët.
- Të gjithë luftojmë për vëmendje.

Si?


- Mblidh të dhënat që funksionojnë më së miri.
- Zhvillo aftësi dhe produkte të ndryshme.
- Përshtate rezultatin me audiencën tënde.

Këshilla 9

Udhëhiq nëpërmjet gjuhës



Mbaj një gjuhë të thjeshtë dhe nxit respektin



Përse duhet të udhëheqësh nëpërmjet gjuhës?

- Fjalët kanë rëndësi – ato i japin formë perceptimeve.
- Që të tregosh respekt dhe të jesh i arritshëm për të gjithë.
- Që t'i japësh rëndësi humanizmit.

Si?


- Përdor fjalë përfshirëse, të thjeshta dhe pozitive.
- Kërko ndihmë nëse nuk je i sigurt se cilat fjalë të përdorësh.
- Investo te përkthimi, duke përfshirë përkthimin kulturor.

Këshilla 10

Përshtate kohën



Suksesi ndodh atëherë kur përgatitja takohet me mundësinë



**Përse duhet
ta përshtatësh
kohën?**

- Lidhja me ngjarjet aktuale rrit arsyeshmërinë.
- Të dish se kur duhet të publikosh diçka kursen kohë dhe burime.
- Informacioni në kohën e duhur mund të të ndihmojë t'u japësh jetë debateve.

Si?

- Ndiq lajmet dhe rrjetet sociale për të gjetur mundësi.
- Krijë materiale që mund t'i përdorësh vazhdimisht.
- Vlerëso me sinqeritet – diçka e re jo gjithmonë është diçka me vlerë.

Organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut anëmbanë Evropës kanë bashkuar forcat me Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, përmes hartimit të “10 këshillave për të komunikuar me efikasitet të drejtat e njeriut”.

Nëse je përkrahës ose mbrojtës i të drejtave të njeriut, këto janë këshillat mbi bazën e të cilave mund të punoni ti dhe skuadra jote.

Le të bëjmë të gjithë më të mirën gjatë komunikimit të të drejtave të njeriut.



TK-09-21-474-SQ-N



fra.europa.eu

 facebook.com/fundamentalrights

 twitter.com/EURightsAgency

 linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency

© FRA, Bashkimi Evropian,
Këshilli i Evropës, ODIHR, OHCHR,
ENNHRI, Equinet, 2022

Riprodhimi është i autorizuar me
kusht që të njihet burimi.



Publications Office
of the European Union